

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI FILLOR**



**PUNIM DIPLOME**

Rudina Hyseni

Mitrovicë, 2020

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI FILLOR**



## **PUNIM DIPLOME**

# **STRATEGJITË E ZBATUARA NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS ANGLEZE NË ARSIMIN FILLOR NË RRETHIN E MITROVICËS**

**Mentor:**

**Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi**

**Kandidatja:**

**Rudina Hyseni**

**Mitrovicë, 2020**

**UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”**

**FACULTY OF EDUCATION**



## **DIPLOMA THESIS**

### **IMPLEMENTED STRATEGIES IN TEACHING ENGLISH IN PRIMARY EDUCATION IN MITROVICA DISTRICT**

**Mentore:**

**Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi**

**Candidate:**

**Rudina Hyseni**

**Mitrovicë, 2020**

# UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI FILLOR



## PUNIM DIPLOME

**Lënda:** Gjuhë angleze

**Titulli i punimit:** Strategjitë e zbatuara në mësimdhënien e gjuhës angleze në arsimin fillor në rrethin e Mitrovicës

**Emri dhe mbiemri:** Rudina Hyseni

**Statusi i studentit:** I rregullt

**Numri i amzës (ID Regjistri):** 1606011057

**Niveli i studimeve:** Bachelor

**Programi i studimit:** Edukim fillor

**Mentorja e punimit:** Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi

**Aprovuar prej komisionit:**

1. \_\_\_\_\_, mentor
2. \_\_\_\_\_, anëtar
3. \_\_\_\_\_, anëtar

**Data e aprovimit:** \_\_\_\_\_

## DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, Rudina Hyseni në përgjegjësi dhe ndërgjegje të plotë deklaroj se ky punim diplome është rezultat i punës sime të pavarur dhe është shkruar në bazë të rregullave akademike. Po ashtu deklaroj materialin që është përdorur për këtë punim është i tëri i cituar.

Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

## FALËNDERIM

Do të ishte e vështirë të arrija këtë sukses pa ndihmën e personave të cilët vazhdimisht më mbështetën, dhe më ndihmuan përgjatë këtij rrugëtimi të studimeve Bachelor.

Unë do të doja ta falënderoja pafundësisht familjen time, cila më përkrahu në çdo hap për arritjen e sukseseve të mija. Gjithashtu falënderoj të gjithë stafin profesional të profesorëve të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Mitrovicës për kontributin dhe angazhimin e tyre përgjatë katër viteve të studimeve. Një falënderim i veçantë shkon për mentorën time Prof. Ass. Dr. Edita Bekteshi e cila me profesionalizëm dhe gatishmëri më shoqëroi nga fillimi e deri tek finalizimi me sukses i këtij punimi.

Faleminderit të gjithëve!

## PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	1
1.1. Shqyrtimi i literaturës.....	2
1.1.1 Gjuha angleze dhe rëndësia e saj.....	2
1.1.2 Fëmijët që mësojnë anglisht si gjuhë dytësore dhe situata në Kosovë.....	4
1.1.3 Vështirësitë e të mësuarit të gjuhës angleze.....	5
1.2 Roli i shkollës dhe mësuesit në mësimin e gjuhës.....	6
1.2.1 Strategjitë e mësimdhënies.....	6
1.2.2 Pse strategjitë e mësimdhënies? .....	7
1.2.3 Karakteristikat e strategjive të mësimdhënies.....	8
1.2.4 Strategjitë e zbatuara në mësimdhënien e gjuhës angleze.....	10
1.2.5 Sfidat e mësuesve në zbatimin e strategjive të mësimdhënies së gjuhës angleze.....	12
2. METODOLOGJIA.....	14
2.1 Dizajni hulumtues.....	14
2.2 Pjesëmarrësit.....	14
2.3 Instrumenti i hulumtimit.....	14
2.4 Mënyra e mbledhjes së të dhënave.....	15
2.5 Analiza e të dhënave.....	15
2.6 Aspekti etik.....	15
3.REZULTATE.....	16
4.DISKUTIM.....	24
5. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME.....	26
LITERATURA.....	27
SHTOJCA.....	33
SHTOJCA A.....	33
SHTOJCA B.....	34

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. <i>Karakteristikat demografike të participantëve</i> .....	16
--	----



## LISTA E FIGURAVE

<i>Grafiku 1.</i> Numri i nxënësve në klasa.....	16
<i>Grafiku 2.</i> Ndjekja e trajnimeve.....	17
<i>Grafiku 3.</i> Përdorimi i strategjive të ndryshme për mësimdhënien e gjuhës angleze..	17
<i>Grafiku 4.</i> Integrimi i teknologjisë.....	18
<i>Grafiku 5.</i> Përdorimi i strategjisë “Puna në grupe dhe në dyshe” .....	18
<i>Grafiku 6.</i> Përdorimi i strategjisë “Bërja e gabimeve”.....	18
<i>Grafiku 7.</i> Përdorimi i demonstrimeve.....	19
<i>Grafiku 8.</i> Përdorimi i organizatorëve grafikë.....	19
<i>Grafiku 9.</i> Përdorimi i vizualizimit.....	20
<i>Grafiku 10.</i> Përdorimi i strategjisë “Mësimi i kulturës”.....	20
<i>Grafiku 11.</i> Përdorimi i strategjisë “Inkurajimi i komunikimit oral”.....	20
<i>Grafiku 12.</i> Përdorimi i strategjisë “Kontrolli i fjalorit”.....	21
<i>Grafiku 13.</i> Përdorimi i strategjisë “Modelimi i gjuhës së synuar”.....	21
<i>Grafiku 14.</i> Përdorimi i strategjisë “Korrigjimi i gabimit”.....	22
<i>Grafiku 15.</i> Përdorimi i strategjisë “Inputi i përpunuar”.....	22
<i>Grafiku 16.</i> Ndihma e strategjive në të nxënit e nxënësve.....	22
<i>Grafiku 17.</i> Vështirësitë në zbatimin e strategjive.....	23

## ABSTRAKTI

Gjuha angleze paraqet dritaren kryesore të botës moderne. Shkolla luan një nga rolet më të rëndësishme në mësimin e kësaj gjuhe. Është shumë e rëndësishme në mësimdhënie identifikimi i sjelljeve të veçanta që ndihmojnë realizimin e mësimit efektiv, e këto sjellje janë referuar si strategji të mësimdhënies. Strategjitë e mësimdhënies janë mjete kryesor në hartimin mësimor. Ato rezultojnë në një qasje didaktike në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke kombinuar dhe organizuar metoda, mjete dhe teknika. Andaj duke u nisur nga rëndësia e tyre, ky hulumtim ka për qëllim të kuptojë zbatimin e këtyre strategjive nga mësimdhënësit e gjuhës angleze. Në hulumtim morën pjesë 16 pjesëmarrës. Instrumenti i përdorur është pyetësi, i cili përfshinë variabla rreth strategjive të mësimdhënies. Të dhënat janë përpunuar me Paketën Statistikore të Shkencave Sociale (SPSS) dhe janë bërë analiza deskriptive. Duke u bazuar në të gjeturat e hulumtimit, kuptojmë se mësuesit përdorin strategji të ndryshme me qëllim që të inkurajojnë në mësimnxënie, strategjitë më të përdorura sipas renditjes janë: inkurajimi i komunikimit oral, inputi i përpunuar, modeli i gjuhës synuar, kontrolli i fjalorit dhe puna në grupe dhe në çift. Po ashtu, rezultatet treguan se 43.8% e pjesëmarrësve shumë rrallë kanë vështirësi në zbatimin e këtyre strategjive, 31.3% rrallë, 18.7% asnjëherë dhe 6.3% shpesh.

Rekomandohet që mësuesit t'i ndjekin vazhdimisht trajnimet, ta bëjnë orën mësimore argëtuese duke përdorur sa më shumë strategji, t'i mos anashkalojnë edhe strategjitë tjera si: integrimin e teknologjisë, vizualizimin, bërjen e gabimeve të qëllimshme, mësimin për kulturën, organizatorët grafikë, demonstrimin dhe korrigjimi i gabimit dhe të bëjnë kombinime të të gjitha strategjive të përmendura më lartë.

***Fjalët kyçe:*** gjuha angleze, strategjitë, mësimdhënie.

## ABSTRACT

English is the main window of the modern world. School plays one of the most important roles in learning this language. It is very important in teaching to identify specific behaviors that help to achieve effective learning, and these behaviors are referred to as teaching strategies. Teaching strategies are the main tool in teaching design. They result in a didactic approach to teaching and learning, combining and organizing methods, tools and techniques. Therefore, given their importance, this research aims to understand the implementation of these strategies by English language teachers. 16 participants participated in the research. The tool used is the questionnaire, which includes variables about teaching strategies. The data were processed with the Social Science Statistical Package (SPSS) and descriptive analyzes were performed. Based on the research findings, we understand that teachers use different strategies in order to encourage learning, the most used strategies in order are: encouraging oral communication, elaborated input, target language modeling, vocabulary control and work in groups and in pairs. Also, the results showed that 43.8% of participants very rarely have difficulty implementing these strategies, 31.3% rarely, 18.7% never and 6.3% often.

It is recommended that teachers constantly to attend trainings, make the lesson fun using as many strategies as possible, do not ignore other strategies such as: technology integration, visualization, making intentional mistakes, learning about culture, graphic organizers , demonstrate and error correction and make combinations of all the strategies mentioned above.

**Keywords:** English language, strategies, teaching.

## 1. HYRJJE

Gjuha është mjeti më i fuqishëm në zhvillimin e çdo qenie njerëzore dhe pa dyshim pasuria më e madhe që posedojmë (Vygotsky, 1986). Sipas tij një zotërim i mirë i gjuhës është sinonim i një aftësie të shëndoshë për të menduar, pra gjuha dhe mendimi janë të pandashëm. Njohja e gjuhës së huaj hap mundësinë për të shkelur jashtë kufirit të jetës tuaj të përditshme duke përfshi formimin e identitetit, rritjen e vetëdijes, zhvillimin e aftësive kryesore përmes dëgjimit, leximit dhe shkrimit, aftësive të ndryshme të të mësuarit si dhe përmirësimin edhe në fusha të tjera (Mahu, 2012). Të mësosh një gjuhë të huaj është një investim për të ardhmen që ka shumë përfitime, qoftë në karrierë, udhëtime apo rritje personale (Watherford, 2006). Hulumentimet e fundit tregojnë se njohja e dy gjuhëve mund të ndihmojë në ndalimin e rënies mendore të moshës dhe se përfitimet që vijnë nga ajo zgjasin gjatë gjithë jetës së personit (Strickland, 2011).

Padyshim që ka mijëra gjuhë në botë dhe është e pamundur të dëgjosh, mësosh ose të i njohësh të gjitha, por ka disa gjuhë të cilat pranohen si gjuhë ndërkombëtare në të gjithë botën siç është anglishtja e cila është shumë e njohur mbase është gjuha më e zakonshme në botë (Zaim, 2011). U vendos si gjuhë ndërkombëtare për të mundësuar komunikimin me njerëz nga vendet e ndryshme (Allen, 2015). Gjuha angleze është rritur shumë në popullaritet dhe përdorimi i saj arrin mbi një miliardë njerëz (Stanyer, 2015).

Është e qartë se të mësosh një gjuhë të huaj kërkon shumë kohë dhe përkushtim, sidoqoftë ajo duhet të mësohet në moshat e hershme në mënyrë që të jetë në gjendje të flasin rrjedhshëm (Zaim, 2011). Kjo theksohet me faktin se shumë vende fillojnë mësimin e gjuhës së huaj në nivelin e shkollës fillore (Edukimi për udhëheqje globale, 2006). Duke pasur parasysh provat, mësimi i gjuhës angleze si gjuhë e huaj, në kombinim me një kurrikulë të fortë thelbësore në shkollën fillore mund të jetë çelësi i arritjeve të përmirësuara në lëndë të tjera, si dhe për përgatitjen e fëmijëve tanë që të jenë pjesëmarrës të suksesshëm në komunitetin global (Stewart, 2005).

Sa i përket mëimit të gjuhës në shkolla, Hashim dhe Yunus (2018) theksojnë se shkollat luajnë një nga rolet më të rëndësishme në ndikimin e përvetësimit së gjuhës angleze si gjuhë e dytë (ESL - English as a Second Language). Ayua (2009) deklaroi se mësuesi është faktori i domosdoshëm në sistemin shkollor dhe se pa mësuesin efektiv do të ishte shumë e vështirë të arrihen qëllimet e dëshiruara.

Rezultatet e mësimdhënies efektive janë të nxënësve të qëndrueshëm, fleksibil, funksional, domethënës dhe përgjithësues (Raba, 2017). Sipas tij, mungesa e efektshmërisë në mësimdhënie është një nga pengesat më të mëdha për suksesin dhe arritjen e qëllimeve të nxënësve. Është shumë e rëndësishme në mësimdhënie identifikimi i sjelljeve të veçanta që ndihmojnë realizimin e mësimin efektiv, e këto sjellje janë referuar si strategji të mësimdhënies (Ayua, 2017). Strategjitë e mësimdhënies të gjuhës angleze janë teknikat ose metodat që një mësues mund të adoptojë për të përmbushur objektiva të ndryshme të nxënësve. Këto strategji ndihmojnë nxënësit të ecin në rrugën e të mësuarit të pavarur, të përqendrojnë vëmendjen, të organizojnë materialin mësimor dhe t'i ndihmojnë mësuesit të ofrojnë një platformë të përshtatshme për mësimin strategjik. Strategjitë i pajisin mësuesit të bëjnë mësimin argëtues dhe të nxënësit të zgjoj dëshirën e nxënësve për ta mësuar gjuhën. Zgjedhja e strategjive është kritike, ajo duhet të bëhet me kujdes maksimal nga mësuesit dhe nxënësit duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit, interesant dhe përvojat e tyre në mënyrë që ata të mund të vetë realizojnë qëllimet e tyre (Richa, et al., 2014). Kështu, në vazhdim do të flitet për disa strategji që përdoren për të fituar rezultate të suksesshme dhe pozitive në gjuhën e të mësuarit.

## **1.1 Shqyrtimi i literaturës**

### ***1.1.1 Gjuha angleze dhe rëndësia e saj***

Meqenëse jemi në epokën e globalizmit dhe çfarëdo që shpiket, zbulohet apo prodhohet nga çdo anë e botës, merr status global. Ndërsa zgjerohet globalizmi, ajo ka nevojë për një gjuhë të përbashkët për të komunikuar me të gjithë njerëzit që jetojnë në botë për të bërë biznes ndërkombëtar, për të udhëtuar, studiuar, punuar etj. Anglishtja njihet si një nga gjuhët më të zgjeruara në botën e komunikimit, duke arritur kështu statusin global. Pothuajse 2 miliardë njerëz flasin anglisht, që do të thotë gati 25% e popullsinë në tokë (Rao, 2019). Mirëpo, mësimi i kësaj gjuhe kërkon praktikë dhe durim të vazhdueshëm. Sido që të jetë, ajo është e domosdoshme për t'u mësuar sepse paraqet dritaren kryesore e botës moderne (Nishanthi, 2018). Duke marrë parasysh këtë, Hubpages (2015) nënvizon si disa rëndësi të saj duke vijuar:

- Anglishtja është gjuha e përbashkët ndërkombëtare. Në kohën tonë aktuale gjuha angleze është thelbësore për komunikim. Para se të gjithash, është gjuha më e zakonshme e huaj. Mund të mos jetë gjuha më e folur në botë, por është gjuhë zyrtare në një numër të madh vendesh.

- Edukimi. Anglishtja është gjithashtu thelbësore për fushën e arsimit. Për shkak të përdorimit të saj të gjerë, shumë vende e kanë përvetësuar atë si gjuhë të dytë dhe inkurajojnë mësimin në të. Shumë programe universitare bëhen në anglisht edhe në vendet jo-anglisht folëse për studentë ndërkombëtarë. Për shkak se është gjuhë mbizotëruese në shkenca, shumica e hulumtimeve dhe studimeve që gjenden në ndonjë fushë të caktuar shkencore janë të shkruara edhe në anglisht.

Rëndësi tjera sipas ESOE (2013) janë:

- Www dhe media. Është gjuha kryesore e shtypit: Më shumë gazeta dhe libra shkruhen në anglisht sesa në ndonjë gjuhë tjetër, dhe pa marrë parasysh se ku jeni në botë, do të gjeni disa nga këto libra dhe gazeta të disponueshme. Shumica e përmbajtjeve të prodhuara në internet (50%) janë në anglisht. Kështu që njohja e gjuhës angleze do t'ju lejojë të merrni një sasi të jashtëzakonshme informacionesh që mund të mos jenë të disponueshme në ndonjë gjuhë tjetër.

- Udhëtimet. Me mirëkuptim dhe komunikim të mirë në anglisht, ju mund të udhëtoni kudo nëpër botë. Për shkak se është gjuha ndërkombëtare për të huajt, është e lehtë të marrësh ndihmë në çdo pjesë të botës. Kjo mund të vërtetohet me faktin se të gjitha rezervimet online e kanë opsionin “anglisht”.

- Ekonomia dhe tregtia. Anglishtja është gjuha dominuese e biznesit dhe nëse njerëzit dëshirojnë të hyjnë në një fuqi punëtore globale ata duhet ta njohin këtë gjuhë pasi është bërë pothuajse e domosdoshme. Hulumtimet nga e gjithë bota tregojnë se komunikimi ndërkufitar i biznesit bëhet më së shpeshti në anglisht.

- Gjuha e argëtimit. E njohur ndryshe si gjuha e Hollywood-it pasi mijëra filma, shfaqje televizive të suksesshme janë në anglisht. Prandaj duke mësuar anglisht do të keni qasje në një pasuri të madhe argëtuese dhe mundësi të për kuptim më të madh kulturor.

Dhe sipas 5minuteenglish (2013):

- Racizmi. Të folurit në anglisht menjëherë hap mundësi, pavarësisht përkatësisë etnike, ngjyrës ose prejardhjes.

Unë mendoj se gjitha këto rëndësi e bëjnë gjuhën angleze të domosdoshme për t'u mësuar. E kjo më së miri dhe më së lehti arrihet kur fillon të mësohet në mosha të hershme.

### ***1.1.2 Fëmijët që mësojnë anglisht si gjuhë dytësore dhe situata në Kosovë***

Ekspozimi i hershëm në anglisht është shumë i rëndësishëm pasi është thelbësore që nxënësit të përvetësojnë gjuhën angleze në moshë të re sepse anglishtja është një gjuhë globale që përdoret në thelb në gjithçka, jo vetëm në nivelin fillor dhe të mesëm (Akçay, Butuner & Arıkan, 2015). Provat tregojnë se fëmijët më lehtë mund të mësojnë gjuhën e huaj (Clarke, 2009). Në fakt, nëse mësohet nga një moshë e re, do të ketë një përfitim shumë të dukshëm për zhvillimin njohës, të tilla si krijimtaria, zgjidhja e problemeve dhe arsytimi. Por, përveç këtyre aftësive, të mësuarit e një gjuhës angleze do t'ju japë aftësi të rëndësishme të jetës. Do të jenë më të aftë të përshtaten dhe përballen me ndryshimet, të merren me situata të panjohura dhe të komunikojnë me njerëz nga të gjitha sferat e jetës. Hulumtimet kanë treguar se të kesh njohuri të anglishtës gjithashtu ndihmon zhvillimin e gjuhës amtare. Përmes mësimi të gjuhës angleze është zbuluar se nxënësit mund të zhvillojnë fjalor më të mirë dhe një nivel të përmirësuar të arsimimit (Mahu, 2012). Kështu, me përvetësimin e anglishtës mund të përmirësohen edhe notat në lëndët tjera (Bhatia & Ritchie, 2004).

Duke u nisur nga rëndësia e gjuhës angleze në botë, e njëjta vlen edhe në Republikën e Kosovës. Fëmijët në vendin tonë u ekspozohen mësimi të gjuhës angleze në moshë të hershme. Ajo fillon nga shkalla e parë dhe vazhdon të mësohet deri në klasën e fundit të shkollës së mesme të lartë. Në shkallën e parë mësohet kryesisht përmes lojës, këngëve, vizatimeve dhe vazhdohet me lexim dhe shkrim në shkallët tjera të Kurrikulës (MASHT, 2011). Sipas Millakut (2016), në shoqërinë tonë mësimi i gjuhës nga klasa e parë paraqet pengesë serioze sepse disa prej tyre vijnë nga zona të ndryshme ku fliten trajta të ndryshme dialektore, dhe në kohën kur detyrohen të përshtaten shqipes standarde të përdorur në shkollë, pikërisht në atë kohë fillojnë ta mësojnë gjuhën e dytë, këtë rast anglishtën. Kjo paraqet krijimin e ngarkesës psikofizike te fëmijët. Përpos kësaj vështirësi tjera janë: mungesa e planit dhe programit të saktësuar për këtë nivel pasi ai i MASHT-it duhet ripunuar, mungesa e infrastrukturës

së brendshme për realizimin e orës dhe mungesa e mësimdhënësve të kualifikuar për këtë moshë.

### *1.1.3 Vështirësitë e të mësuarit të gjuhës angleze*

Vështirësitë e të mësuarit të një gjuhe të dytë ose të huaj ndryshojnë nga një nxënës tek tjetri, ndryshim i formuar nga aftësia që secili posedon (Departamenti i politikave dhe praktikës së arsimit NAE, 2007). Ka shumë vështirësi, siç janë:

- Transferimi negativ. Transferimi negativ nënkupton përdorimin e të njëjtës strukturë të gjuhës burimore kur përkthehet në gjuhën e synuar (Rhalmi, 2014). Të gjitha gjuhët kanë strukturat e tyre, prandaj nxënësit duhen të jenë të njohur me strukturat e gjuhës angleze pasi shkakton paqartësi në gjuhë (Mohammed, 2018).

- Dallimet kulturore. Pothuajse çdo shoqëri ka kulturën e vet duke e diferencuar atë nga shoqëritë e tjera (Rhalmi, 2014). Mirëpo, kjo i shqetëson nxënësit pasi ata ndjehen të paaftë për të kuptuar shprehje apo fjali të ndryshme për shkak të dallimeve kulturore (Abdullah, 2015).

- Theksi. Gjuha angleze ka thekse të ndryshme si: Amerikane, Britanike, Australiane etj. Variantet e theksit mund të shkaktojnë probleme për nxënësit duke bërë që nxënësit ta ngatërrojnë kuptimin (Derwing dhe Munro, 2015).

- Zhargoni dhe kolokualizmi. Zhargoni dhe kolokualizmi nënkupton shprehjet që përdoren në gjuhën joformale. Gjuha angleze përbëhet nga shumë të tilla dhe kjo është më të vërtetë sfiduese për nxënësit që të mbulojnë këto shprehje (Hayat, 2009).

- Gjuhë arbitrare. Sipas Yule (2014), anglishtja është gjuhë arbitrare që nënkupton se nuk ka marrëdhënie mes formës dhe kuptimit.

- Qëndrimi. Kannan (2009) shprehet se qëndrimi i nxënësit ka efekt të madh pasi qëndrimi pozitiv i tyre ndryshon drejtpërdrejt gjuhët e të mësuarit. Mungesa e motivimit, vetëbesimit, stresi, ankthi dhe frika për të bërë gabime ndikojnë që gjuha të mos arrihet të mësohet si duhet (Bingol, 2014).

- Mjedisi. Në kohën e mësimit të një gjuhe, atmosfera mësimore duhet të merret parasysh në mënyrë të konsiderueshme. Mjedisi i sigurt dhe liria e bashkëveprimit janë mjete të përshtatshme dhe të preferueshme për të mësuar (Bingol, 2014).



- Gramatika. Anglishtja ka një sistem të komplikuar të rregullave gramatikore. Çdo rregull përdoret në një kohë dhe situatë specifike dhe kjo bënë që nxënësit të mërzhiten (Hayat, 2009).

- Shqiptimi. Një tjetër vështirësi me të cilën përballen nxënësit është shqiptimi i saktë i fjalëve . Kjo ndodh pasi shqiptimi është i lidhur fort me gjuhën e parë në të cilën disa tinguj nuk ekzistojnë, duke e bërë kështu të vështirë për nxënësit. Gjithashtu, nxënësit kanë vështirësi në ato tinguj që nuk shqiptohen në të njëjtën mënyrë me fjalë të ndryshme (Hayat 2009).

## ***1.2 Roli i shkollës dhe mësuesit në mësimin e gjuhës***

Shumë vende në të gjithë botën zgjedhin të mësojnë më shumë se një gjuhë në shkollat e tyre sepse studimet tregojnë përfitimet e shumta të të qenit shumëgjuhësh (Strickland, 2011). Përveç në shtëpi, shkolla është vendi ku nxënësit mësojnë anglishtën si gjuhë të dytë (ESL). Përvetësimi i një gjuhe nuk është vetëm të kuptuarit e konceptit ose formatit të asaj gjuhe, por të qenit në gjendje të flasësh gjuhën rrjedhshëm është ajo që i bën nxënësit të fitojnë gjuhën (Dong & Ren, 2013). Shkollat luajnë një rol të rëndësishëm në ekspozimin ndaj nxënësve mbi rëndësinë e gjuhës angleze dhe si mund ta përvetësojnë gjuhën (Ahmed, 2015; Nguyen & Terry, 2017). Detyra e mësuesit nuk është vetëm të folurit brenda klasave, por edhe udhëzimi i nxënësve dhe sigurimi i një atmosfere miqësore për nxënësit, të cilat ndikojnë në lehtësimin e procesit të mësimin të gjuhës angleze (Kannan, 2009). Kryerja e një veprimtarie mësimore është në thelb një rrjet ose grup vendimesh që mësuesi merr për të lidhur elementet parësore të punës së tij dhe për të ndërtuar zgjidhjen më të mirë në lidhje me situatën mësimore. Ai duhet të gjejë një formulë racionale dhe të përshtatshme për të kombinuar metodat, procedurat teknikat, mjetet dhe format e organizimit që çojnë në mësimdhënie efektive. Zgjedhja e procedurave për mësim në lidhje me lëndën e caktuar, këtë rast lëndën e gjuhës angleze, paraqet strategjinë e mësimdhënies (Neacs, 1990).

### ***1.2.1 Strategjitë e mësimdhënies (Teaching strategies)***

Strategjitë e mësimdhënies paraqesin plane të përgjithësuara për një mësim i cili përfshin strukturën, objektivat mësimore dhe një skicë të taktikave të planifikuara, të nevojshme për zbatimin e strategjive (Issac, 2010). Më gjerësisht, sipas Orlich, Harder, Callahan, Trevisan, & Brown (2010), strategjitë e mësimdhënies janë:

- Përpjekje për arritjen e objektivave,
- Një ndërthurje e metodave të ndryshme,
- Një qasje makro,
- E konsiderojnë mësimin si shkencë,
- Kanë qëllim të krijojnë një mjedis mësimor të favorshëm,
- Bazohen në teoritë moderne të organizimit,
- Objektivat e paracaktuara , bëhen strategji,
- Sjelljet e mësuesve dhe nxënësve dhe marrëdhënia e tyre e ndërsjellë.

Strategjitë e mësimdhënies rezultojnë në një qasje didaktike në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke kombinuar dhe organizuar metodat, mjetet dhe format e grupimit të pjesëmarrësve (Cerghit, 2006). Dihet që strategjia e mësimdhënies është mjeti kryesor në hartimin mësimor (Stefan, 2003; Reiser & Dempsey, 2011; & Regeluth , 2013). Prandaj edhe çdo mësues duhet të ketë liri të madhe për të hartuar punën e tij. Kjo arrihet duke vizatuar grafikët, tabelat ose thjesht skemat mendore të cilat mund të ndihmojnë në rritjen e aftësisë së tyre për të vendosur dhe përdorur kombinime efektive të metodave, mjeteve dhe burimeve tjera të trajnimit (Iurea, Neacsu, Safta & Suditu, 2011; Keegan, 2013).

### ***1.2.2 Pse strategjitë e mësimdhënies?***

Sipas Richa et al., (2014), metodat tradicionale të mësimdhënies zakonisht rrotulloheshin rreth mësuesit duke shpjeguar një temë dhe nxënësit duke mbajtur shënime. Ajo ishte përqendruar në më shumë se një përvojë pasive mësimore me ndërveprim minimal mes nxënësve dhe mësuesit. Ndërsa ky lloj mësimdhënie mund të ketë qenë efektiv më herët, por sot nxënësit kanë nevojë për metodologji të ndryshme për t'i ndihmuar ata të bëhen nxënës te pavarur dhe strategjikë. Strategjitë e mësimdhënies janë provuar se u sjellin dobi nxënësve me veçoritë e tyre të fuqishme si:

- Përfshijnë procesin mësimor hap pas hapi me një numër qasjesh inovative

- Mbështet nxënësit me praktikë të udhëhequr dhe të pavarur, duke modeluar dhe trajtuar situata në jetën reale
- Jep platformë nxënësve për të shfaqur aftësitë, idetë dhe njohuritë e tyre ekzistuese për një temë të veçantë
- Inkurajon nxënësit të vetë-monitorojnë dhe vlerësojnë mësimin e tyre
- Strategjitë efektive janë në dispozicion për nxënës pavarësisht sukseseve të tyre, për lëndë të ndryshme etj. (Richa, et al., 2014).

Sipas tyre ka pasur shumë hulumtime në këtë fushë dhe është zbuluar se nxënësit zhvillojnë sistemin e tyre të të kuptuarit. Është jo vetëm e rëndësishme të vendoset për “çfarë të mësohet”, por gjithashtu duhet kushtojmë vëmendje “si t’ua mësojmë”. Strategjitë mësimdhënies u përgjigjen këtyre pyetjeve, duke eksploruar mjediset më të përshtatshme, në të cilat nxënësit mund të përmirësojnë aftësitë e tyre të vetë-mësimit dhe të bëhen nxënës strategjikë.

### ***1.2.3 Karakteristikat e strategjive të mësimdhënies***

Sipas Ionescu & Radu (2001) karakteristikat thelbësore të strategjive të mësimdhënies janë:

- Kanë karakter normativ pa ngurtësinë e një rregulli. Përbërës të situatave dinamike, fleksibile dhe me elasticitet të brendshëm. Mbajnë gjurmët e stilit të mësimdhënies, krijimtarisë dhe personalitetit të mësimdhënësit.
- Kanë një funksion strukturues dhe modelues për të lidhur situatat e të nxënësve ku vendosen nxënësit dhe të nxisin mekanizmat e tyre psikologjik të të mësuarit.
- Përbërësit e strategjisë (metodat, mjetet dhe format e organizimit të punës) formojnë një sistem, duke vendosur lidhjen midis tyre, madje edhe ndërlidhjet dhe ndërvarësitë. Këto strategji mund të zërthehen në një seri veprimesh, hapash, rregullash të sjelljes specifike për sekuencat e ndryshme mësimore.
- Nuk identifikohen as me sistemin metodologjik të zgjedhur, as me metodën themelore mësimore sepse strategjia e mësimdhënies synon procesin e mësimin në tërësi, dhe jo një sekuencë të vetme.

- Kanë kuptim probabilistik, domethënë që një strategji e veçantë mësimore, megjithëse e themeluar shkencërisht dhe e përshtatshme për burimet psikologjike të pjesëmarrësve, nuk mund të garantojë suksesin e procesit të mësuarit, sepse ekziston një numër i madh i variablave që mund të ndërhyjnë në proces.
- I përfshijnë nxënësit në situata të veçanta të të mësuarit dhe racionalizojnë përmbajtjen e mësimit me personalitetin e tyre.
- Krijojnë një kornizë ideale për ndërveprime midis përbërësve të tjerë të mësimit.

Duke marrë parasysh karakteristikat e strategjive të mësimdhënies, Devlin dhe Samarawickrema (2010) propozuan dhjetë parime të një strategjie efektive të mësimdhënies. Ato janë:

(1) Mësimdhënia dhe hartimi i kurrikulave duhet të përqendrohen në plotësimin e nevojave të ardhshme të nxënësve duke nënkuptuar zhvillimin e aftësive gjenetike të tyre siç janë të menduarit kritik, puna në ekip dhe aftësitë e komunikimit,

(2) Nxënësit duhet të kenë një kuptim të plotë të koncepteve themelore edhe nëse kjo nënkupton më pak përmbajtje të mbuluar,

(3) Rëndësia e asaj që mësohet duhet të përcaktohet duke përdorur shembuj nga jeta reale, aktuale ose lokale dhe duke përdorur teori në praktikë,

(4) Besimet e nxënësve duhet të sfidohen për t'u marrë me konceptet e gabuara,

(5) Një larmi detyrash mësimore që përfshijnë nxënësit, përfshirë diskutimin e nxënësve, duhet të ndodhin në mënyrë që të zhvillohet mësimi kuptimplotë,

(6) Marrëdhënie origjinale, empatike me nxënësit duhet të vendosen në mënyrë që të mund të zhvillohet ndërveprimi,

(7) Mësuesit duhet të motivojnë nxënësit duke shfaqur entuziazmin e tyre, duke inkurajuar ata dhe duke siguruar klasa interesante, të këndshme dhe aktive,

(8) Hartimi i kurrikulës duhet të sigurojë që qëllimet, konceptet, aktivitetet mësimore dhe vlerësimi të jenë në përputhje me arritjen e rezultateve të të nxënësve në lidhje me nevojat e ardhshme të nxënësve,

(9) Mësimi duhet të jetë plotësisht i planifikuar, por fleksibil, në mënyrë që të bëhen adaptime të nevojshme bazuar në reagime gjatë orës së mësimi,

(10) Vlerësimi duhet të jetë në përputhje me rezultatet e dëshiruara të mësimi, pra të jenë detyra autentike për disiplinën ose profesionin.

#### ***1.2.4 Strategjitë e zbatuara në mësimdhënien e gjuhës angleze (Implemented strategies in teaching English Language)***

Nisur nga fakti se ekzistojnë strategji të ndryshme të mësimdhënies, e njëjta skemë përdoret edhe në mësimdhënien e gjuhës angleze. Ka shumë strategji për mësimdhënien e gjuhës angleze. Megjithatë, sipas Dean (2019), disa nga më të përdorura janë:

- Bërja e gabimeve: Bërja e gabimeve të qëllimshme dhe kërkimi nga nxënësit që t'i korrigjojnë ato është një mënyrë e shkëlqyeshme kur dëshirojmë të kërkojmë një kuptim më të thelluar nga nxënësit. Për shembull, mësuesi shkruan një fragment në tabelë me gabime gramatikore, pastaj udhëzon nxënësit të identifikojnë këto gabime dhe ta rishkruajnë saktë fragmentin.
- Puna në ekip: Ndarja e klasës në ekipe të ndryshme për të kryer detyra është një strategji që funksionon çudira. Detyrat në grup inkurajojnë punën në ekip dhe ndihmojnë klasën të ketë sukses dhe paraqet një mënyrë argëtuese dhe interaktive për të dhënë mësim.
- Integrimi i teknologjisë në klasë: Teknologjia është pjesë thelbësore e punëve moderne. Ajo mundëson që të përmirësohen planet mësimore me aktivitete arsimore në internet. Nxënësit jo vetëm që kënaqen me kohën që kalojnë në internet, por gjithashtu do të fitojnë një kuptim më të thellë të punës së mësuesit në klasë.
- Demonstrimi: Me paraqitjen e një teme të re përfshihet edhe demonstrimi. Ndërsa disa nxënës do të jenë në gjendje të kuptojnë një koncept të ri duke dëgjuar vetëm informacionin, të tjerët duhet ta shohin atë.
- Organizatorët grafikë: Organizatorët grafikë si tabelat e byrekut dhe diagramet e Venit janë mënyra të shkëlqyeshme për të shfaqur informacionin

vizualisht. Kur kërkojmë nga nxënësit të krijojnë një, ata duhet të zbatojnë njohuritë e tyre në një mënyrë vizuale. Kjo gjithashtu i ndihmon të krijojnë lidhje dhe të kuptojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet.

- Vizualizimi: Ndhmat vizuale të tilla si dërrasat inteligjente dhe projektorët mund të përmirësojnë mësimin në klasë. Duke iu referuar ilustrimeve, ndërsa flet mësuesi lejon që të gjithë në klasë të marrin atë që u nevojitet nga mësimi.

Përpos këtyre ka edhe të tjera si:

- Mësimi për kulturën: Fitimi i njohurive për kulturën e gjuhës angleze rrit efektivitetin e mësuesit kur bën plane mësimore dhe bashkëvepron me nxënësit (Resilient Educator, 2020).

- Inkurajimi i komunikimit oral: Nxënësit kanë mënyra të ndryshme natyrore për të mësuar, por inkurajimi i nxënësve për të komunikuar verbalisht në klasë i ndihmon ata të praktikojnë gjuhën. Duke biseduar me nxënësit për të përshkruar atë që jeni duke bërë, veshur dhe planifikuar, ndihmon ata të zhvillojnë vetëdijen gjuhësore dhe kulturore (Resilient Educator, 2020).

- Kontrollat e fjalorit: Kjo strategji ndihmon nxënësit për ta bërë fjalën më të lehtë për ta kuptuar dhe mbajtur mend. Mundëson që ata të lidhin fjalorin e ri me fjalët që ata tashmë i dinë (Resilient Educator, 2020).

- Modelimi i gjuhës së synuar: Hill dhe Flynn (2006) sugjerojnë që struktura dhe forma gjuhësore duhet të mësohen në kontekste autentike dhe jo përmes ushtrimeve të kufizuara në fletoret e punës të gjuhës. Modelimi i gjuhës së synuar paraqet një strategji jashtëzakonisht të rëndësishme, pasi mund të jetë udhëzuesi i vetëm i nxënësit se si përdoret gjuha e huaj në një mjedis natyror.

- Korrigjimi i gabimit: Sipas Hill dhe Flynn (2006), mënyra më e mirë për të dhënë korrigjime gabuese kur nxënësit bëjnë gabime gramatikore ose shqiptuese është thjesht modelimi i saktë pa tërhequr vëmendjen për gabimin.

- Inputi i përpunuar: Përdorimi i përsëritjeve, parafrazimi, fjalimi i ngadaltë duke thjeshtësuar sintaksën dhe fjalorin është strategji efektive që ndihmon fëmijët të mësojnë një gjuhë të dytë (Nunan, 2000).

Është e vështirë të thuhet që njëra strategji funksionon më mirë se tjetra. Megjithatë kur një mësues kombinon strategji efektive të mësimdhënies,

nxënësit e tij kanë më shumë mundësi për të performuar më mirë në klasë (Dean, 2019).

### *1.2.5 Sfidat e mësuesve në zbatimin e strategjive të mësimdhënies së gjuhës angleze*

Mësuesit duke u munduar të zbatojnë strategji të dobishme për të zvogëluar vështirësitë e mësimin të gjuhës angleze, ata përballen me sfida të ndryshme (Chen, 2007; Nunn, 2011). Mungesa e trajnimeve paraqet një sfidë të madhe për mësimdhënësit (Songbatumis, 2017). Aplikimi i strategjive nga mësuesit e patrajnuar është e vështirë sepse ata duhet të mendojnë jo vetëm si të transferojnë katër aftësitë gjuhësore por edhe si ta mbajnë motivin dhe entuziazmin e nxënësve (Ansari, 2012). Sipas Emery (2012), një tjetër sfidë është numri i madh i nxënësve në klasë, i cili mund të ketë efekt negativ në mësimdhënie dhe nxënie. Sfidë e mundshme për mësuesit janë shqetësimet me nivelin e anglishtës që ata kanë. Ata duhet të rinovojnë vazhdimisht njohuritë e tyre dhe të pajisen veten me përparimet në shoqëri dhe përdorimin e teknologjisë në mjedisin arsimor dhe në përgjithësi (Khan, 2005). Ai po ashtu, argumenton se nxënësit duhet t'i ekspozohen më shumë anglishtës, pasi mungesa e ekspozimit e bënë më të vështirë për mësuesit t'i inkurajojë ata në përdorimin e gjuhës. Pastaj është aksesin i kufizuar i burimeve. Pamjaftueshmëria e burimeve ndikon që mësuesit të mos jenë në gjendje të japin mësim efektiv (Songbatumis, 2017). Po ashtu sipas tij, qëndrimi negativ dhe demotivimi për lëndën e vështirësojnë procesin e aplikimit të strategjive. Dhënia e udhëzimeve është një tjetër sfidë. Detyra më e rëndësishme që mësuesit duhet të kryejnë është ajo e organizimit të nxënësve. E kjo nuk mund të arrihet pa udhëzime të qarta (Harmer, 2007). Gjithashtu edhe përdorimi i materialeve shtesë. Ndodh që ato mund të përmbajnë gabime dhe të mos jenë në përshtatje me nivelin e nxënësve (Patekar, 2017). Edhe organizimi i punës në çifte dhe në grup nuk është i lehtë. Përzgjedhja e nxënësve për punë në çifte apo grup duhet të bëhet në mënyrë të duhur (Harmer, 2007). Përpos këtyre, sfidë tjetër është koha e pamjaftueshme pasi që nuk lejon mësuesit të përfshihen në mësim më të individualizuar dhe t'u japin atyre mundësi për t'u përgjigjur nevojave të nxënësve, duke paraqitur kështu sfidën më të madhe në zbatimin e strategjive (Michalak & Bavli, 2018).

Prandaj edhe ky punim ka për synim të hulumtoj se a kanë vështirësi mësuesit e gjuhës angleze në rrethin e Mitrovicës në zbatimin e strategjive të mësimdhënies, a përdorin ata strategji të ndryshme dhe cilat prej tyre i përdorin më së shumti.



## 2. METODOLOGJIA

### *2.1 Dizajni hulumtues*

Ky hulumtim sipas metodës është hulumtim kuantitativ. Duke parë rëndësinë e strategjive në të nxëniet e nxënësve, është caktuar qëllimi i këtij hulumtimi. Qëllimi hulumtimit është të kuptojë a përdorin strategji të ndryshme mësuesit në mësimdhënien e gjuhës angleze në arsimin fillor në rrethin e Mitrovicës, cilat janë më të përdorurat prej tyre dhe a kanë vështirësi t'i zbatojnë ato.

Pyetjet kërkimore të ngritura për këtë hulumtim janë:

P.1 A përdorin strategji të ndryshme mësimdhënësit e gjuhës angleze?

P.2: Cilat janë strategjitë më të përdorura?

P.3: A kanë vështirësi mësimdhënësit e gjuhës angleze në zbatimin e strategjive?

### *2.2 Pjesëmarrësit*

Në hulumtim morën pjesë gjithsej 16 mësimdhënës të gjuhës angleze në rrethin e Mitrovicës. Prej tyre 12 femra dhe 4 meshkuj. 9 mësimdhënës ishin me vend të punës në qytet ndërsa 7 në fshatra. 8 mësues ishin me përvojë pune më shumë se 10 vite, 5 me përvojë 6-10 dhe 3 me 1-3 vjet.

### *2.3 Instrumenti*

Për realizimin e këtij hulumtimi është vendosur të përdoret pyetësori pasi është metoda më e përshtatshme, duke mundësuar që të dhënat të mbledhen në një kohë të shkurtër dhe të mbuloj një popullsi më të gjerë. Për mbledhjen e të dhënave është vendosur të përdoret pyetësori i adaptuar nga Dean, M., Hill, J. D., Flynn, M. K., Nunan, D. & Resilient Educator. Pyetësori përmban pyetje demografike si emri dhe mbiemri, gjinia, vendi i punës, numri i nxënësve në klasë dhe ndjekja e

trajtimeve. Në total ka 21 pyetje. Gjithashtu, në vete ngërthen 5 alternativa, nga gjithmonë deri tek asnjëherë.

#### ***2.4 Mënyra e mbledhjes së të dhënave***

Të dhënat nga ky hulumtim janë mbledhur përmes pyetësorit. Mirëpo në pamundësi për t'i mbledhur në teren për shkak të pandemisë COVID-19, mbledhja e tyre është realizuar në mënyrë elektronike. Mësuesve të gjuhës angleze u është dërguar pyetësori i krijuar me Google Forms, në email-at e tyre. Ky proces ka zgjatur nëntë ditë, nga data 18.06.2020 deri më 26.06.2020. Gjithashtu kam kërkuar që të përgjigjen në të gjitha pyetjet dhe përgjigjet të jenë sa më të sinqerta.

#### ***2.5 Analiza e të dhënave***

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave vazhdova me analizën e tyre. Për analizën e të dhënave është përdorur programi SPSS (Paketë Statistike për Shkencat Shoqërore). Janë bërë analiza deskriptive dhe nga rezultatet e nxjerra janë krijuar grafikët.

#### ***2.6 Aspekti etik***

Gjatë realizimit të hulumtimit është respektuar etika hulumtuese. Në bazë të saj mësuesit kanë qenë të informuar në kohë, kishin të drejtë të mos ta plotësojnë pyetësorin apo ta plotësojnë atë anonim, mundësia për të lënduar individët e përfshirë në hulumtim ka qenë minimale. Të dhënat e mbledhura janë përdorur vetëm për qëllimin e këtij hulumtimi, ato nuk janë publikuar ose parë nga persona të paautorizuar. Mësuesve u është treguar se ky hulumtim po realizohet në kuadër të finalizimit të studimeve të mia dhe nuk ka asnjë qëllim tjetër dhe se të dhënat e tyre do të jenë konfidenciale.

### 3. REZULTATE


Në këtë kapitull do të paraqiten gjetjet e hulumtimit të bërë, të cilat jepen në formë përshkruese të shoqëruara me tabela dhe figura dhe të përforcuara me shpjegim.

Tabela 1

*Karakteristikat demografike të participantëve*


	N	%
<b>Gjinia</b>		
Femër	12	75
Mashkull	4	25
<b>Vendi i punës</b>		
Fshat	7	44
Qytet	9	56
<b>Përvoja</b>		
1-5	3	19
6-10	5	31
Më shumë	8	50

Në hulumtim morën pjesë 16 pjesëmarrës, me numër të femrave shumë më të lartë sesa të meshkujve. Po ashtu me numër pak më të lartë me vend pune në qytet sesa në fshat. Dominonin mësuesit me më shumë përvojë pune, pastaj ata me 6-10 vjet dhe më së paku 1-5 vjet.




*Grafiku 1. Numri i nxënësve në klasa*

Në grafikun 1. është paraqitur numri i nxënësve në klasa të raportuar nga mësimitdhënësit. Shihet se dominojnë klasat me më shumë se 20 nxënës me 62.5%, kurse klasat deri në 20 nxënës 37.5%.




*Grafiku 2. Ndjekja e trajnimeve*

Sa i përket ndjekjes së trajnimeve është krijuar grafiku 2. ku një pjesë e madhe e mësimitdhënësve me 43.6% ka deklaruar se rrallë i ndjekin trajnimet, 31.3% shpesh, 18.8% shumë rrallë dhe 6.3% gjithmonë.




*Grafiku 3. Përdorimi i strategjive të ndryshme në mësimitdhënien e gjuhës angleze.*

Për pyetjen kërkimore *a përdorin strategji të ndryshme mësimitdhënësit e gjuhës angleze* është krijuar grafiku 3. Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe me 56.3% kanë deklaruar se gjithmonë përdorin strategji të ndryshme, 37.5% përdorin shpesh dhe 6.3% e tyre përdorin rrallë. Kurse asnjë mësimitdhënës nuk është përgjigjur me shumë rrallë dhe asnjëherë.




*Grafiku 4. Integrimi i teknologjisë.*

Për pyetjen *a integrojnë mësimdhënësit teknologji në orën e gjuhës angleze*, është krijuar grafiku 4. ku 43.7% janë përgjigjur shpesh, 37.5% rrallë dhe 18.8% shumë rrallë. Ndërsa me gjithmonë dhe asnjëherë nuk është përgjigjur asnjë mësimdhënës.




*Grafiku 5. Përdorimi i strategjisë "Puna në grupe dhe në dyshe".*

Sipas grafikut 5. për pyetjen *a i ndani nxënësit në grupe ose në dyshe për të kryer detyra*, pjesa më e madhe me 56.3% janë përgjigjur shpesh, 25% gjithmonë dhe 18.7% rrallë. Ndërsa asnjë mësimdhënës nuk është përgjigjur me shumë rrallë dhe asnjëherë.




*Grafiku 6. Përdorimi i strategjisë "Bërja e gabimeve".*

Për pyetjen *a bëni gabime të qëllimshme dhe kërkonti nga nxënësit t'ju korrigjojnë*, është krijuar grafiku 6. 43.8% e mësimitdhënësve janë përgjigjur rrallë, 37.5% shpesh, 12.5% shumë rrallë dhe 6.3% asnjëherë. Ndërsa me gjithmonë nuk është përgjigjur asnjë mësimitdhënës.




*Grafiku 7. Përdorimi i demonstrimeve.*

Në grafikun 7. është paraqitur sa shpesh përdorin mësimitdhënësit e gjuhës angleze demonstrime. Prej tyre 43.8% kanë deklaruar se përdorin shumë rrallë, 31.2% rrallë dhe 25% shpesh. Kurse asnjë mësimitdhënës nuk është përgjigjur me gjithmonë dhe asnjëherë.




*Grafiku 8. Përdorimi i organizatorëve grafikë.*

Për pyetjen *a përdorni organizatorë grafikë si tabelat e byrekut dhe diagramet e Venit*, është krijuar grafiku 8. Këtu shihet se pjesa më e madhe janë përgjigjur rrallë me 43.7%, shpesh 37.5%, shumë rrallë 12.5% dhe shumë rrallë vetëm 6.3%. Kurse me asnjëherë nuk është përgjigjur asnjë mësimitdhënës.




*Grafiku 9. Përdorimi i vizualizimit.*

Ndërsa në pyetjen *a përdorni dërrasa inteligjente dhe projektorë për përmirësimin e mësimit në klasë*, është krijuar grafiku 9. Rezultatet janë 37.5% rrallë, 31.2% shumë rrallë, 18.8% shpesh dhe 12.5% gjithmonë. Asnjë mësues nuk është përgjigjur me asnjëherë.




*Grafiku 10. Përdorimi i strategjisë "Mësimi i kulturës".*

Në grafikun 10. janë paraqitur përgjigjet për pyetjen *a i kushtoni rëndësi mësimit të kulturës*. 37.5% e mësuesve janë përgjigjur rrallë, 31.2% shpesh, 18.8% gjithmonë dhe 12.5% shumë rrallë. Ndërsa me asnjëherë nuk është përgjigjur asnjë mësues.




*Grafiku 11. Përdorimi i strategjisë "Inkurajimi i komunikimit oral".*

Për pyetjen *a i inkurajoni nxënësit për të komunikuar në anglisht* është paraqitur grafiku 11. Rezultatet tregojnë një përdorim të madh të kësaj strategjie me 75% gjithmonë dhe 25% shpesh. Kurse me rrallë, shumë rrallë dhe asnjëherë nuk është përgjigjur asnjë mësuesdhënës.



*Grafiku 12.* Përdorimi i strategjisë “Kontrolli i fjalorit”.


Në grafikun 12. janë paraqitur përgjigjet për pyetjen *a përdorni strategjinë kontrolli i fjalorit për të mundësuar nxënësit të lidhin fjalorin e ri me fjalët që ata tashmë i dinë.* 43.8% janë përgjigjur gjithmonë, 37.5% shpesh dhe rrallë 18.7%. Ndërsa asnjë mësuesdhënës nuk është përgjigjur me shumë rrallë dhe asnjëherë.



*Grafiku 13.* Përdorimi i strategjisë “Modelimi i gjuhës së synuar”.


Për pyetjen *a flisni vetëm anglisht në orën e gjuhës angleze,* është krijuar grafiku 13. Përgjigjet tregojnë një përdorim të madh të kësaj strategjie me 50% gjithmonë, 43.7% shpesh dhe vetëm 6.3% rrallë. Ndërsa me shumë rrallë dhe asnjëherë nuk është përgjigjur asnjë mësuesdhënës.






*Grafiku 14.* Përdorimi i strategjisë “Korrigjimi i gabimit”.

Në grafikun 14. Janë dhënë përgjigjet për pyetjen *a i korrigjoni nxënësit menjëherë pasi të bëjnë ndonjë gabim*. Grafiku tregon se 37.5% e mësimitdhënësve janë përgjigjur shpesh, 31.2% rrallë, 25% gjithmonë dhe 6.3% shumë rrallë. Ndërsa asnjë mësimitdhënës nuk është përgjigjur me asnjëherë.




*Grafiku 15.* Përdorimi i strategjisë “Inputi i përpunuar”.

Për pyetjen *a bëni përsëritje, parafrazim, fjalim të ngadaltë duke thjeshtësuar sintaksën dhe fjalorin*, është krijuar grafiku 15. Rezultatet tregojnë se 62.5% janë përgjigjur gjithmonë dhe 37.5% shpesh. Ndërsa asnjë mësimitdhënës nuk është përgjigjur me rrallë, shumë rrallë dhe asnjëherë.



*Grafiku 16.* Ndhimja e strategjive në të nxënit e nxënësve.

Për pyetjen *a mendoni se këto strategji ndihmojnë në të nxënit e nxënësve*, është krijuar grafiku 16. ku shihet se pjesa më e madhe janë përgjigjur gjithmonë me 56.2% dhe shpesh 43.8%. Ndërsa me rrallë, shumë rrallë dhe asnjëherë nuk është përgjigjur asnjë mësuesdhënës.



*Grafiku 17. Vështirësitë në zbatimin e strategjive.*

Dhe në grafikun 17. janë paraqitur rezultatet për pyetjen kërkimore *a kanë vështirësi mësuesdhënësit e gjuhës angleze në zbatimin e strategjive*. Pjesa më e madhe kanë deklaruar shumë rrallë me 43.8%, pastaj rrallë 31.3%, asnjëherë 18.7% dhe shpesh 6.3%. Ndërsa asnjë mësuesdhënës nuk është përgjigjur me gjithmonë.

#### 4. DISKUTIMI

Strategjitë e mësimdhënies të gjuhës angleze janë teknikat ose metodat që mësuesi i përdor në mënyrë që të fitoj rezultate pozitive dhe të suksesshme. Këto strategji i pajisin mësuesit të bëjnë mësimin argëtues dhe të nxënësit ta zgjoj dëshirën për të mësuar (Richa, et al., 2014). Kështu, mësuesit duhet të kërkojnë gjithmonë strategji të dobishme për të zvogëluar vështirësitë e mësimin të gjuhës angleze, mirëpo gjatë zbatimit të tyre ata hasen edhe me sfida të ndryshme (Chen, 2007; Nunn, 2011). Prandaj ky hulumtim shtjelloi temën “Strategjitë e zbatuara në mësimdhënien e gjuhës angleze” ku fokusi i tij ishte të kuptojë a përdoren strategjitë e ndryshme, cilat prej tyre janë më të përdorurat dhe a kanë vështirësi mësimdhënësit e gjuhës angleze të arsimit fillor në rrethin e Mitrovicës në zbatimin e këtyre strategjive.

Në këtë punim u parashtruan tri pyetje kërkimore dhe rezultatet që janë dal nga analizat e bëra, na mundësuan të japim përgjigje këtyre pyetjeve.

Rezultatet për pyetjen e parë kërkimore “*A përdorin strategji të ndryshme mësimdhënësit e gjuhës angleze?*”, treguan se 56.3% e mësimdhënësve të gjuhës angleze përdorin gjithmonë strategji të ndryshme të mësimdhënies, 37.5% shpesh dhe 6.3% rrallë. Një përqindje shumë e vogël vërehet që i përdorin rrallë dhe që asnjë prej tyre nuk ka deklaruar se përdor strategji të ndryshme shumë rrallë ose asnjëherë. Nga kjo mund të arrijmë në përfundim se mësimdhënësit përdorin mjaftueshëm strategji të ndryshme dhe iu kushtojnë rëndësi përdorimit të tyre. Kjo lidhet me faktin se ata janë të vetëdijshëm për dobitë që u sjellin nxënësve dhe kushtojnë vëmendje jo vetëm “çfarë mësohet” por edhe “si t’ua mësojnë” (Richa, et al., 2014).

Rezultatet për pyetjen e dytë kërkimore “*Cilat janë strategjitë më të përdorura?*”, treguan se strategjia më e përdorur nga mësimdhënësit e gjuhës angleze është “inkurajimi i komunikimit oral”. Strategji kjo mjaftë me rëndësi pasi duke komunikuar nxënësit zhvillojnë vetëdijen gjuhësore dhe kulturore (Resilient Educator, 2020). Më pas vjen strategjia “inputi i përpunuar”. Përdorimi i përsëritjeve, parafrazimi, fjalimi i ngadaltë duke thjeshtësuar sintaksën dhe fjalorin është strategji efektive që ndihmon fëmijët të mësojnë një gjuhë të dytë (Nunan, 2000). Pastaj strategjia “modelimi i gjuhës synuar”, e cila mund të jetë udhëzuesi i vetëm i nxënësit se si përdoret gjuha e huaj në një mjedis natyror (Hill & Flynn, 2006). Sipas tyre edhe strategjia “kontrolllet e fjalorit” i ndihmon nxënësit për ta bërë fjalën më të lehtë për ta

kuptuar dhe mbajtur mend. Kjo është e katërta për nga përdorimi dhe e pesta është “puna në grupe dhe në çift”, strategji kjo që funksionon çudita (Dean, 2019).

Dhe për pyetjen e fundit kërkimore “*A kanë vështirësi mësimdhënësit e gjuhës angleze në zbatimin e strategjive?*”, rezultatet treguan se një pjesë e madhe prej 43.8% shumë rrallë kanë vështirësi në zbatimin e strategjive, pastaj 31.3% rrallë, 18.7% asnjëherë dhe vetëm 6.3% shpesh. Asnjë mësimdhënës nuk ka deklaruar se ka gjithmonë vështirësi. Kjo bie në kundërshtim me Songbatumis (2017), pasi sipas tij mungesa e trajnimeve paraqet sfidë për mësimdhënësit në aplikimin e strategjive ndërsa rezultatet tona treguan se një pjesë e madhe e mësimdhënësve prej 43.6% rrallë i ndjekin trajnimet. Një tjetër sfidë është edhe numri i madh i nxënësve në klasë (Emery, 2012) ndërsa në anën tjetër rezultatet tona treguan se 62.5% e pjesëmarrësve kanë klasa me më shumë se 20 nxënës, duke bërë kështu të bie në kundërshtim edhe me këtë studim.

## 5. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Nga të gjeturat e këtij hulumtimi mund të arrijmë në përfundim se mësimdhënësit e gjuhës angleze, në arsimin fillor në rrethin e Mitrovicës përdorin mjaftë strategji të ndryshme për mësimdhënien e gjuhës angleze. Kjo paraqet një gjë shumë pozitive pasi nga shqyrtimi literaturës kuptuam se rëndësia e strategjive është e padiskutueshme në procesin mësimor. Po ashtu, gjetjet treguan se strategjia më e përdorur është inkurajimi i komunikimit oral dhe pastaj për të vijuar: inputi i përpunuar, modelimi i gjuhës synuar, kontrolli i fjalorit dhe puna në grupe dhe në çift. Strategji këto tejet efektive për përvetësimin e gjuhës së dytë. Ndërsa sa i përket vështirësive për zbatimin e tyre mund të konkludojmë se pjesa më e madhe e mësimdhënësve shumë rrallë kanë vështirësi, ndërsa pjesa tjetër me këtë renditje: rrallë, asnjëherë dhe një përqindje shumë e vogël shpesh. Pra, janë të pakta vështirësitë që i hasin edhe pse shumica prej tyre rrallë i ndjekin trajnimet dhe japin mësim në klasa me numër të madh të nxënësve.

Siç e dimë se mësimdhënia cilësore dhe mësiminxënia e nxënësve janë të ndërlidhura ngushtë mes veti. Prandaj ky studim propozon edhe disa rekomandime. Së pari rekomandohet që mësuesit t'i ndjekin vazhdimisht trajnimet dhe të jenë të informuar për zhvillimet e fundit në fushën e arsimit, të mundohen ta mbajnë motivimin, interesin dhe entuziazmin e nxënësve gjatë gjithë kohës për ta mësuar gjuhën duke e bërë orën sa më argëtuese e kjo arrihet duke përdorur sa më tepër strategji. Pastaj t'i mos anashkalojnë edhe strategjitë tjera si: integrimin e teknologjisë, vizualizimin, bërjen e gabimeve të qëllimshme, mësimin për kulturën, organizatorët grafikë, demonstrimin dhe korrigjimi i gabimit. Strategjia më e rekomandueshme nga të gjitha, për mësimdhënien e gjuhës angleze në arsimin fillor është kombinimi i të gjitha strategjive të përmendura më lartë.

## LITERATURA

- 5minuteenglish (2013). Why learn English: 10 Reasons to learn English. Qasur në:  
www.5minuteenglish.com më 10.06.2020
- Abdullah, S. (2015). Challenges for teaching English as a Second or foreign language and their remedies. *International Journal of Humanities and Management Science*.
- Ahmed, S. (2015). Attitudes towards English Language Learning among EFL Learners at UMSKAL. *Journal of Education and Practice*, 6(18), 6–17.
- Akcay, A., Butuner, T. F., & Arikan, A. (2015). Reasons behind young learners' learning of foreign languages. *International Journal of Language Academy*, 3(2), 56–68.
- Al Hosni, S. (2014). Speaking difficulties encountered by young EFL learners. *International Journal on Studies in English Language and Literature (IJSELL)*, 2(6), 22–30.
- Allen, L (2015). Lucy Allen explores the impact of global English. Qasur në  
www.languagedebates.wordpress.com më: 14.06.2020
- Ansari, A. A. (2012). Teaching of English to Arab students: Problems and remedies. *Educational Research* 3(6), 519-524.
- Ayua, G. A. (2012). Assessment of Makurdi serving teachers' expectations on what is an effective primary science teacher education programme. *Journal of Research in Curriculum and Teaching*, 6 (1), 459-465.
- Bhatia, T. & Ritchie, W.C. (2004). *The Handbook of Bilingualism*. Oxford: Blackwell Publishing.
- Bingol M, N. Y. (2014). Listening comprehension difficulties encountered by students in Second Language Learning class. *Journal of Education and Instructional studies in the World*, 4.
- Brewster, J., Ellis, G. and Girard, D. (2002) *The primary English teacher's guide* (new edition). Harlow: Pearson Education Limited.

- Cerghit, I. (2006). Metode de invatamant. Iasi: Editura Polirom.
- Chen, Y. (2007). Learning to learn: The impact of strategy training. *ELT Journal*, 61 (1). doi: 10.1093/elt/ccl041
- Clarke, P. (2009). Supporting children learning English as a Second Language in the Early Years (birth to six years). *Victorian Curriculum and Assessment Authority*.
- Dean, M. (2020). 10 effective teaching strategies for every classroom. Qasur në: <https://www.classcraft.com/blog/features/effective-teaching-strategies-for-every-classroom/> më 04.07.2020
- Derwing, T. M. & Munro, M. J. (2017). Pronunciation fundamentals: Evidence-based perspectives for L2 teaching and research. *Applied Linguistics*, 38(3), 430–433. doi:10.1093/applin/amw041
- Devlin, Marcia and Samarawickrema, Gayani. (2010). The criteria of effective teaching in a changing higher education context. *Higher Education Research & Development*, 29: 2, 111-124. doi: 10.1080/07294360903244398.
- Dong, G., & Ren, H. (2013). The role of age in second Language acquisition a psychological perspective. *British Journal of English Linguistics*, 1(1), 1–6.
- Education for Global Leadership (2006). The Importance of international studies and foreign language instruction for U.S. economic and national security. *Committee for Economic Development*.
- Emery, H. (2012). A global study of primary English teachers' qualifications, training and career development. *ELT Research Papers*, 1-32.
- ESL Education: Strategies for Teaching English Language Learners: Resilient Educator. (2020). Qasur në: <https://resilienteducator.com/classroom-resources/esl-teaching-strategies-for-educators/> më 08.07.2020
- ESOE blog-Eastbourne School of English (2013). 4 reasons why learning English is so important. Qasur në: [www.esoe.co.uk/blog](http://www.esoe.co.uk/blog) më 11.06.2020

- Harmer, J. (2007). *The practice of English language teaching*. (4th edition). Harlow: Pearson Longman.
- Hashim, U. H, & Yunus, M. M. (2018). English as a Second Language (ESL) Learning: Setting the right environment for second language acquisition. *Journal of Education and Teacher Training*, 3(2), 207-215. doi: 10.24042/tadris.v3i2.2941
- Hayat Al-Khatib, M. A. (2009). *Difficulties that arab students face in learning English language*. Lebanon: Arab Open University.
- Hill, J. & Flynn, K. (2006). *Classroom instruction that works with English Language Learners*. Virginia: ASCD.
- HubPages (2015). *The importance of the English language in today's world*. Qasur në: [www.hubpages.com](http://www.hubpages.com) më: 11.06.2020
- Ionescu, M. & Radu, I. (2001). *Didactica moderna*. Cluj-Napoca: Editura Dacia.
- Issac, J. C. (2010). *Methods and strategies of teaching: An overview*. Pondicherry University Press.
- Iurea, C., Neacsu, I., Safta, C. G., & Suditu, M. (2011). The study of the relation between the teaching methods and the learning styles: The impact upon students' academic conduct. *Procedia-Social and Behavioral Sciences*, 11, 256-260.
- Kannan, R. (2009). *Difficulties in Learning English As Second Language*. Qasur në: [www.esp-world.info](http://www.esp-world.info) më: 23.06.2020
- Keegan, D. (2013). *Theoretical principles of distance education*. London: Routledge.
- Khan, I. A. (2011). Challenges of teaching/learning English and management. *Global Journal of Human Social Science*, 11, 68-79.
- Long, R. (1969). Linguistic universals, deep structure, and English neither or second language. *TESOL Quarterly*, 3, 123-132. doi: 10.2307/3586098



- Madalinska-Michalak, J., & Bavli, B. (2018). Challenges in teaching English as a foreign language at schools in Poland and Turkey. *European Journal of Teacher Education*, 41(5), 688–706. doi:10.1080/02619768.2018.1531125
- Mahu, D. P. (2012). Why is learning English so beneficial nowadays. *International Journal of Communication Research*, 2(4), 374-376.
- MASHT (2011). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovë. Prishtinë.* Qasur në: [https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/korniza-e-kurrikules11.pdf?fbclid=IwAR1BoKoj5egLEqT0FkI\\_eAlphoM1z5t1bQgxW1FwHfS-gr0eTXD\\_EbgG900](https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/korniza-e-kurrikules11.pdf?fbclid=IwAR1BoKoj5egLEqT0FkI_eAlphoM1z5t1bQgxW1FwHfS-gr0eTXD_EbgG900) më: 21.06.2020
- Mlinaku, Sh. (2016). Mësimi i anglishtës nga klasa e parë në Kosovë. Qasur në: [https://www.academia.edu/29780275/M%C3%8BSIMI\\_I\\_ANGLISHTES\\_NGA\\_KLASA\\_E\\_PAR%C3%8B\\_N%C3%8B\\_KOSOV%C3%8B](https://www.academia.edu/29780275/M%C3%8BSIMI_I_ANGLISHTES_NGA_KLASA_E_PAR%C3%8B_N%C3%8B_KOSOV%C3%8B) më 24.06.2020
- Mohammed, M. H. (2018). Challenges of learning English as foreign language (EFL) by non-native learners. *International Journal of Social Science and Economic Research*, 3(4), 1381-1400.
- NEA Education Policy and Practice. (2007). English Language Learners face unique challenges. Washington.
- Neacsu, I. (1990). *Instruire si invațare*. Bucuresti: Editura Stiintifica.
- Nguyen, H., & Terry, D. R. (2017). English learning strategies among EFL learners: A narrative approach. *IAFOR Journal of Language Learning*, 3(1), 4–19.
- Nishanthi, R. (2018). Important of learning English in today world. *International Journal of Trend in Scientific Research and Development*, 3(1), 871-874. doi: 10.31142/ijtsrd19061
- Nunan, D. (2000) *Language Teaching Methodology*. Oxford: Phoenix.
- Nunn, R. (2011). Improving method in use through classroom observation. *LERI*, 49, 55-70. doi: 10.1515/iral.2011.003

- Orlich D.C., Harder R.J., Callahan R.C., Trevisan M.S. & Brown A.H., (2010). Teaching strategies: A guide to effective instruction, Ninth Edition. Wadsworth, Cengage Learning.
- Patekar, J. (2017). Common challenges in delivering a successful foreign language lesson. *Strani Jezici*, 101-118.
- Raba, A. A. A. M. & Harzallah, H. T. M. (2015). Effective teaching from An-Najah National University M.A. students' perspectives. *Journal of Languages and Culture*, 6(6), 52 - 60.
- Rao, P. S. (2019). The importance of English in the modern era. *Asian Journal of Multidimensional Research*, 8(1), 7. doi: 10.5958/2278-4853.2019.00001.6
- Regeluth, C. M. (2013). Instructional-design theories and models: A new paradigm of instructional theory. London: Routledge.
- Reiser, R. A., & Dempsey, J. V. (2011). Trends and issues in instructional design and technology. Pearson.
- Rhalmi, M. (2014). Second language learning difficulties. My English page. Qasur në: <http://www.myenglishpages.com/blog/second-language-learning-difficulties/> më: 28.06.2020
- Richa, et al. (2014). Instructional Strategies: Find the best approach to encourage independent learning. Udeemy Blog. Qasur në: [blog.udemy.com/instructional-strategies/](http://blog.udemy.com/instructional-strategies/) më: 04.07.2020
- Songbatumis, A. M. (2017). Challenges in teaching English faced by English teachers at MTsN Taliwang, Indonesia. *Journal of Foreign Language Teaching & Learning*, 2(2).
- Stanyer, O. (2015). Global English: „Vampire or provider“? asks Olivia Stanyer. Qasur në: [www.languagedebates.wordpress.com](http://www.languagedebates.wordpress.com) më: 14.06.2020
- Stefan, M. (2003). Teoria situatiilor educative. Bucuresti : Editura Aramis.

- Stewart, J. (2005). Foreign language study in elementary schools: Benefits and implications for achievement in reading and math. *Early Childhood Education Journal*, 33(1), 11-16.
- Strickland, A. (2011). Benefits of foreign language instruction. Honors Senior Theses/Projects, 78.
- Vygotsky, L . (1986). *Thought and Language*, Cambridge, MIT Press, MA, USA.
- Weatherford, H.J. (2006). Personal benefits from foreign language study. Washington,DC: ERIC Clearinghouse on Languages and Linguistics. ERIC Digest.
- Weatherford, H.J. (2006). *Personal Benefits from Foreign Language Study*. Washington, DC: ERIC Clearinghouse on Languages and Linguistics. ERIC Digest.
- Yule, G. (2014). *The Study Of Language*. United States of America: Cambridge University press.
- Zaim, C. (2011). Benefits of learning a foreign language. *International Logistics and Transportation*, 15. Qasur në [https://www.academia.edu/6580048/AFE\\_155\\_-\\_Benefits\\_of\\_Learning\\_a\\_Foreign\\_Language\\_më](https://www.academia.edu/6580048/AFE_155_-_Benefits_of_Learning_a_Foreign_Language_më) 22.06.2020

## SHTOJCAT

### SHTOJCA A

### FORMULAR PAJTIMI



### UNIVERSITETI I MITROVICËS 'ISA BOLETINI'

*Rr.U.Kaçaniku, p.n. 40000 Mitrovicë  
Republika e Kosovës  
FAKULTETI I EDUKIMIT*

### FORMULAR PAJTIMI

#### **I/E nderuar,**

Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Mitrovicës, në organizimin e studimeve ka të paraparë zhvillimin e punimit të kërkimor. Në këtë kuadër, unë kam zgjedhur të zhvilloj hulumtimin me titull „Stategjitë e zbatuara në mësimdhënien e gjuhës angleze në arsimin fillor në rrethin e Mitrovicës“.

Formulari ju ofrohet për tu pajtuar që të jeni pjesë e këtij hulumtimi. Ne ju sigurojmë që të dhënat e mbledhura në këtë studim, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të këtij studimi. Ju mund të zgjidhni të jeni pjesëmarrës në kushte anonimiteti ose konfidencialiteti. Ne respektojmë zgjedhjen tuaj.

Duke besuar dhe respektuar në bashkëpunimin me ju, ne ju falënderojmë.

Ju lutem nënshkruani konfirmimin tuaj.

Ofruesi i formularit

-----

-----

----

Ju faleminderit!

**SHTOJCA B**

**UNIVERSITETI I MITROVICES**  
**'ISA BOLETINI'**

*Rr.U.Kaçaniku, p.n. 40000 Mitrovicë*  
*Republika e Kosovës*  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PYETËSOR**

Të nderuar mësimdhënës të gjuhës angleze,

Faleminderit paraprakisht për kohën që po e ndani për të plotësuar këtë pyetësor i cili është pjesë e punimit të diplomës dhe ka për qëllim të dijë për strategjitë e zbatuara në mësimdhënien e gjuhës angleze. Ne ju sigurojmë që të dhënat e mbledhura në këtë studim do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të këtij hulumtimi dhe janë plotësisht konfidenciale. Ju lusim që të përgjigjeni me sinqeritet në pyetjet.

1. Emri dhe mbiemri (opsional) \_\_\_\_\_
2. Gjinia:            1) Femër                    2) Mashkull
3. Lokaliteti ku punoni:            1) Fshat                    2) Qytet
4. Përvoja juaj si mësimdhënës/e:    1) 1-5                    2) 6-10                    3) Më shumë
5. Numri i nxënësve në klasë:            1) Deri në 20                    2) Më shumë se 20
6. Unë i ndjek trajnimet: 1) Gjithmonë 2) Shpesh 3) Rrallë 4) Shumë rrallë 5) Asnjëherë

Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme duke përdorur këto shkallë:

- 1) Gjithmonë 2) Shpesh 3) Rrallë 4) Shumë rrallë 5) Asnjëherë

7.	Unë përdori strategji të ndryshme për mësimdhënien e gjuhës angleze.	1 2 3 4 5
8.	Unë integroj teknologji në orën e gjuhës angleze.	1 2 3 4 5
9.	Unë i ndaj nxënësit në grupe ose në dyshe për të kryer detyra.	1 2 3 4 5
10.	Unë bëj gabime të qëllimshme dhe kërkoj nga nxënësit të më korrigjojnë.	1 2 3 4 5
11.	Unë përdori demostrime të ndryshme.	1 2 3 4 5
12.	Unë përdori organizatorë grafikë si tabelat e byrekut dhe diagramet e Venit.	1 2 3 4 5
13.	Unë përdori dërrasa inteligjente dhe projektorë për përmirësimin e	1 2 3 4 5

	mësimit në klasë.	
14.	Unë i kushtoj rëndësi mësimit të kulturës.	1 2 3 4 5
15.	Unë i inkurajoj nxënësit për të komunikuar në anglisht.	1 2 3 4 5
16.	Unë përdori strategjinë kontrolli i fjalorit për të mundësuar nxënësit të lidhin fjalorin e ri me fjalët që ata tashmë i dinë.	1 2 3 4 5
17.	Unë flas vetëm anglisht në orën e gjuhës angleze.	1 2 3 4 5
18.	Unë i korrigjoj nxënësit menjëherë pasi të bëjnë ndonjë gabim.	1 2 3 4 5
19.	Unë bëj përsëritje, parafrazim, fjalim të ngadaltë duke thjeshtësuar sintaksën dhe fjalorin.	1 2 3 4 5
20.	Unë mëndo që këto strategji ndihmojnë në të nxënësit e nxënësve.	1 2 3 4 5
21.	Unë kam vështirësi në zbatimin e strategjive.	1 2 3 4 5